



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

Tiranë, më 23.07.2024

*(Dokument parlamentar)*  
*Komision përgjegjës*

## RAPORT

### PËR PROJEKTLIGJIN

**"PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 60/2023 "PËR TRAJTIMIN E VEÇANTË TË STUDENTËVE QË NDJEKIN PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MJEKËSI E PËRGJITHSHME" NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË"**

#### *I. Hyrje*

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 17.09.2024, mori në shqyrtim projektligjin "Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 60/2023 "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Mjekësi e përgjithshme" në institucionet publike të Arsimit të Lartë.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik e shqyrtoi projektligjin bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktuan relatore znj. Enslemvera Zake dhe znj. Eralda Bano.

Në datat 10 dhe 16 shtator 2024, Komisioni zhvilloi dy seanca dëgjimore: me një grup studentësh të Mjekësisë dhe me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për diskutimin e projektligjit.

Në mbledhjen e Komisionit të datës 17 shtator, për të diskutuar projektligjin, ishin të ftuar deputetët nismëtarë, përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të Ministrisë së Financave:

1. znj. Entela Ramosacaj – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
2. z.Sajmir Mucmataj - drejtor i përgjithshëm në Ministrinë e Financave,
3. znj. Etilda Gjonaj – deputete.

## **II. Baza kushtetuese e projektligjit**

Projektligji i propozuar është në përputhje me nenet 78, 83 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, si dhe në zbatim të vendimit nr.1, datë 25.1.2024, të Gjykatës Kushtetuese. Ndryshimet dhe shtesa e propozuar në projektligj janë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet: *“1. Kufizime të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizimet nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave, dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”* Me anë të këtij projektligji, me uljen e afateve përkatësisht nga 5 vjet në 3 vjet për studentët e vitit të parë, nga 3 vjet në 2 vjet për studentët e vitit të dytë deri në të katërt dhe 1 vit për studentët e vitit të pestë ose të gjashtë, plotësohet jo vetëm kriteri i domosdoshmërisë, por dhe i përshtatshmërisë së masës, duke bërë që dispozitat e projektligjit të plotësojnë testin e proporcionalitetit.

Ndryshimet e propozuara në projektligj janë në përputhje edhe me objektivat e parashikuara në nenin 59 të Kushtetutës. Interesi publik për të garantuar plotësimin e nevojave për burime njerëzore në kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë është mjaft i lartë, prandaj edhe dispozitat që përcillen përmes këtij projektligji janë hartuar në proporcion me nevojat e diktuar për përmbushjen e këtij interesi të lartë publik, në zbatim edhe të dispozitivit të vendosur nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.1/2024.

Projektligji me plotësimin e vakuumit ligjor në nenin 6 të ligjit nr. 60/2023, të konstatuar nga Gjykata Kushtetuese, garanton respektimin e të drejtave kushtetuese të parashikuara nga nenet 49, pika 1, dhe 57 të Kushtetutës, në drejtim të (i) kriterëve objektive të punësimit me prioritet, (ii) trajtimit financiar në kuadër të sigurimit të mjeteve të nevojshme të jetesës, (iii) përlllogaritjes së pagesës së periudhës në pritje në kohëzgjatjen e detyrimit për punësim.

Gjithashtu, ndryshimet e propozuara nuk cenojnë thelbin e së drejtës për arsim, pasi çdo kandidati/studenti që regjistrohet apo ndjek studimet në programet e studimit të ciklit të dytë në fushën e mjekësisë i garantohet, së pari, e drejta për arsim me plotësimin e kriterëve ligjore për ndjekjen e këtij programi studimi dhe, së dyti, ai ka të drejtën e zgjedhjes nëse do të përfitojë apo jo nga

lehtësitë/përfitimet që krijohen përmes këtij projektligji, nëpërmjet zgjedhjes së tij për të nënshkruar apo jo një marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik.

### **III. Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit**

- **Qëllimi**

Ky projektligj propozohet me qëllimi kryesor plotësimi i vakuimit ligjor të krijuar në ligjin nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të Arsimit të Lartë”, me vendimin nr. 1, datë 25.1.2024, të Gjykatës Kushtetuese.

- **Objektivat që synohen të arrihen:**

- Plotësimi i vakuimit ligjor të krijuar nga shfuqizimi i fjalëve “5 (pesë) vjet” në nenin 4, pika 1, shkronja “b”; “5-vjeçar” në nenin 4, pika 1, shkronja “c”; “3 (tre) vjet” në nenin 4, pika 2, shkronja “a”; “3-vjeçar” në nenin 4, pika 2, shkronja “b”; “2 (dy) vjet” në nenin 4, pika 3, shkronja “a”; “2-vjeçar” në nenin 4, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të Arsimit të Lartë” .

-Plotësimi i vakuimit ligjor me konstatimin e ometimit ligjor në nenin 6 të ligjit nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të Arsimit të Lartë”, lidhur me mungesën e kriterëve objektive të punësimit me prioritet, trajtimin financiar në kuadër të sigurimit të mjeteve të nevojshme të jetesës, si dhe përlllogaritjen e pagesës së periudhës në pritje në kohëzgjatjen e detyrimit për punësim.

- Sigurimi i zbatimit efektiv të vendimit nr.1/2024 të Gjykatës Kushtetuese, duke parashikuar dispozita të reja në përputhje me detyrat e lëna nga Gjykata Kushtetuese.

- **Risitë që sjell projektligji:**

- Garantimi i parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes edhe në afatet e tjera tre dhe dyvjeçare;
- plotësimi i vakuimit ligjor lidhur me punësimin e mjekëve dhe garantimi i të drejtave për trajtimin financiar në kuadër të sigurimit të mjeteve të nevojshme të jetesës;
- përlllogaritja e pagesës së periudhës në pritje në kohëzgjatjen e detyrimit për të punuar;

- ndjekja e procedurave për t'u punësuar në institucionet shëndetësore sipas nevojave për mjekë të shpallura nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe përzgjedhja e vendeve të punës.

- **Përmbajtja e projektligjit**

Projektligji “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, në institucionet publike të Arsimit të Lartë” është i strukturuar në 5 nene.

**Neni 1** i projektligjit parashikon se në nenin 1, ku përcaktohet objekti i ligjit, pas fjalëve “për trajtimin e studentëve”, të shtohen fjalët “shtetas shqiptar”. Ky përcaktim ka për qëllim të përjashtojë nga zbatimi i të drejtave dhe detyrimeve sipas këtij ligji shtetasit joshqiptarë, duke qenë se kryesisht studentët e huaj apo nga trojet kanë përcaktime të veçanta për regjistrimin e tyre në institucionet publike të Arsimit të Lartë në fushën e mjekësisë.

**Neni 2** i projektligjit parashikon ndryshime në nenin 4 të ligjit nr. 60/2023, duke parashikuar që në nenin 4, pika 1, shkronja “b”, fjalët “5 (pesë) vjet” të zëvendësohen me fjalët “3 (tre) vjet”.

Në nenin 4, pika 1, shkronja “c”, fjalët “5-vjeçar” të zëvendësohen me fjalët “3-vjeçar”.

Në nenin 4, pika 2, shkronja “a”, fjalët “3 (tre) vjet” të zëvendësohen me fjalët “2 (dy) vjet”.

Në nenin 4, pika 2, shkronja “b”, fjalët “3-vjeçar” të zëvendësohen me “2-vjeçar”.

Në nenin 4, pika 3, shkronja “a”, fjalët “2 (dy) vjet” të zëvendësohen me fjalët “1 (një) vit”.

Në nenin 4, pika 3, shkronja “b”, fjalët “2-vjeçar” të zëvendësohen me fjalët “1-vjeçar”.

**Neni 3** i projektligjit parashikon plotësimin e ometimit ligjor në nenin 6 të ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të Arsimit të Lartë”, mbi procedurat dhe kriteret objektive të punësimit me prioritet, trajtimin financiar në kuadër të sigurimit të mjeteve të nevojshme të jetesës, si dhe përlllogaritjen e pagesës së periudhës në pritje në kohëzgjatjen e detyrimit për punësim. Konkretisht duke parashikuar riformulimin e nenit 6 si vijon:

Në pikën 1 përcaktohet se studenti që përfundon programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe ka nënshkruar marrëveshje sipas përcaktimeve të këtij ligji, në momentin e lindjes së të drejtës për punësimin e tij, ndiqen procedurat e mëposhtme:

a) punësohet në institucionet shëndetësore sipas nevojave për mjekë të shpallura nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe përzgjedhja e vendeve të punës bëhet nga mjeku i licencuar, në bazë të renditjes sipas notës mesatare të përfundimit të studimeve;

b) koha e kryerjes së procedurës për punësimin e mjekut nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë është brenda 3 (tre) muajve nga momenti i lindjes së të drejtës për punësim.

Në pikën 2 përcaktohet se në rastet kur punësimi nuk realizohet brenda 3 (tre) muajve, për shkaqe që nuk varen nga mjeku, deri në krijimin e mundësisë për punësim në institucionet shëndetësore publike, për një periudhë deri në 9 (nëntë) muaj, mjeku i lind e drejta të trajtohet me 80% të pagës së mjekut të përgjithshëm në kujdesin parësor, për një periudhë jo më të gjatë se ky afat, ose të zgjedhë të punësohet në institucionet shëndetësore jopublike në vend, duke njoftuar ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe duke ruajtur të drejtën për punësim prioritar brenda periudhës 9 (nëntë) mujore në institucionet shëndetësore publike.

Në pikën 3 përcaktohet se periudhat sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni përfshihen brenda afateve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, kur mjeku punësohet; në rast të kundërt, pas përfundimit të tyre, konsiderohet i përmbushur detyrimi sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe mjeku ka të drejtën të pajiset me diplomën përkatëse universitare.

Në pikën 4 autorizohen ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë për të përcaktuar me udhëzim të përbashkët mënyrën dhe procedurat e punësimit me prioritet.

**Neni 4** i projektligjit parashikon dispozita kalimtare mbi shtrirjen e efekteve të dispozitave të këtij projektligji, të cilat do të jenë nga viti akademik 2024-2025 deri në vitin akademik 2028-2029.

#### ***IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Projektligji “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, në institucionet publike të Arsimit të Lartë” nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Europian (*aquis communautaire*).

#### ***V. Konsultimi publik***

Në mbështetje të pikës 2/1, të nenit 68, të Rregullores së Kuvendit, ky projektligj është publikuar në regjistrin elektronik të konsultimit publik në faqen e Kuvendit, si dhe është zhvilluar seancë degjimore me studentet e Fakultetit të Mjekësisë.

## VI. Efektet financiare

Për të plotësuar vakuumin ligjor të konstatuar nga Gjykata Kushtetuese lidhur me trajtimin financiar në kuadër të sigurimit të mjeteve të nevojshme të jetesës, si dhe përlllogaritjen e pagesës së periudhës në pritje në kohëzgjatjen e detyrimit për punësim, është parashikuar, së pari, detyrimi i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë për punësimin e mjekësve brenda 3 (tre) muajve pas licencimit, sipas notës mesatare, pa zhvilluar procedura konkurrimi. Po ashtu, është detajuar procedura që do të ndiqet për punësimin dhe angazhimin e mjekut ende të papunësuar për shkaqe që nuk varen prej tij. Përgjatë kësaj periudhe mjeku do të ketë të drejtën të trajtohet me 80% të pagës së mjekut të përgjithshëm në kujdesin parësor, për një periudhë jo më të gjatë se ky afat, ose të zgjedhë të punësohet në institucionet shëndetësore jopublike në vend, duke njoftuar ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe duke ruajtur të drejtën për punësim prioritar brenda periudhës 9 (nëntë) mujore në institucionet shëndetësore publike.

Ndikimet ekonomike të parashikuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë sa vijon: **Skenari i parë**, nëse të gjithë mjekët pranojnë të nënshkruajnë kontratën me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nuk do të punësohet asnjë në sistemin shëndetësor publik, efekti financiar do të ishte 1540 mjekë me pagë sa 80% e pagës së mjekut të përgjithshëm në Kujdesin Parësor x 9 muaj paga e mjekut të familjes aktualisht 105,500 lekë/ muaj, pa përfshirë vjetërsinë në punë. Me VKM-në e re të pagave që pritet të miratohet, paga e mjekut të familjes shkon 124,000 lekë/ muaj, pa përfshirë vjetërsinë në punë, 80% e të cilës kap vlerën 99,200 lekë. Efekti për 5 vitet e ardhshme parashikohet në shumën prej 1,374,912,000 lekë/ i ndarë në pesë vite sa vijon.

Për mjekët që kanë filluar studimet në vitin akademik 2019-2020 dhe që pritet të përfundojnë ciklin e plotë të studimeve në vitin 2024, nëse nuk punësohen brenda periudhës 9-mujore, parashikohet që për këtë periudhë të përfitojnë 80% të pagës mesatare të mjekut të familjes 124,000 lekë, për muaj 99.200/muaj x 260 mjekë x 9 muaj = 232,128,000 lekë.

Për mjekët që kanë filluar studimet në vitin akademik 2020-2021 dhe që përfundojnë ciklin e plotë të studimeve në vitin 2025, nëse nuk punësohen brenda periudhës 9-mujore, parashikohet që për këtë periudhë të përfitojnë 80% të pagës mesatare të mjekut të familjes 124,000 lekë, për muaj 99.200/muaj x 260 mjekë x 9 muaj = 232,128,000 lekë.

Për mjekët që kanë filluar studimet në vitin akademik 2021-2022 dhe që përfundojnë ciklin e plotë të studimeve në vitin 2026, nëse nuk punësohen brenda periudhës 9-mujore, parashikohet që për këtë periudhë të përfitojnë 80% të pagës mesatare të mjekut të familjes 124,000 lekë, për muaj 99.200/muaj x 260 mjekë x 9 muaj = 232,128,000 lekë.



Për mjekët që kanë filluar studimet në vitin akademik 2022-2023 dhe që përfundojnë ciklin e plotë të studimeve në vitin 2027, nëse nuk punësohen brenda periudhës 9-mujore, parashikohet që për këtë periudhë të përfitojnë 80% të pagës mesatare të mjekut të familjes 124,000 lekë, për muaj  $99.200/\text{muaj} \times 360 \text{ mjekë} \times 9 \text{ muaj} = 321,408,000$  lekë.

Për mjekët që kanë filluar studimet në vitin akademik 2023-2024 dhe që përfundojnë ciklin e plotë të studimeve në vitin 2028, nëse nuk punësohen brenda periudhës 9-mujore, parashikohet që për këtë periudhë të përfitojnë 80% të pagës mesatare të mjekut të familjes 124,000 lekë, për muaj  $99.200/\text{muaj} \times 360 \text{ mjekë} \times 9 \text{ muaj} = 357,120,000$  lekë.

**Skenari i dytë** dhe më i mundshëm, aktualisht vetëm në shërbimin e kujdesit parësor ka 250 vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm dhe 111 të tjera me shtyrje pensioni. Deri në vitin 2029 pritet të mbushin moshën për pension edhe 204 mjekë të tjerë, pra për periudhë 2024-2029 sistemi publik shëndetësor ka nevojë për të paktën 565 mjekë të përgjithshëm. Nëse do të llogaritet efekti financiar për periudhën nga momenti i licencimit deri në fillimin e marrëdhënieve të punës maksimalisht 2-3 muaj, efektet financiare të parashikuara do të jenë 1540 mjekë me pagë 99,200 lekë /muaji  $\times 3\text{muaj}=305,536,000$  lekë/ i ndarë në 5 vite.

Për mjekët që kanë filluar studimet në vitin akademik 2019-2020 dhe që pritet të përfundojnë ciklin e plotë të studimeve në vitin 2024, nëse nuk punësohen brenda periudhës 3-mujore, parashikohet që për këtë periudhë të përfitojnë 80% të pagës mesatare të mjekut të familjes 124,000 lekë, për muaj  $99.200/\text{muaj} \times 260 \text{ mjekë} \times 2 \text{ muaj} = 51,584,000$  lekë.

Për mjekët që kanë filluar studimet në vitin akademik 2020-2021 dhe që përfundojnë ciklin e plotë të studimeve në vitin 2025, nëse nuk punësohen brenda periudhës 3-mujore, parashikohet që për këtë periudhë të përfitojnë 80% të pagës mesatare të mjekut të familjes 124,000 lekë, për muaj  $99.200/\text{muaj} \times 260 \text{ mjekë} \times 2 \text{ muaj} = 51,584,000$  lekë.

Për mjekët që kanë filluar studimet në vitin akademik 2021-2022 dhe që përfundojnë ciklin e plotë të studimeve në vitin 2026, nëse nuk punësohen brenda periudhës 3-mujore, parashikohet që për këtë periudhë të përfitojnë 80% të pagës mesatare të mjekut të familjes 124,000 lekë, për muaj  $99.200/\text{muaj} \times 260 \text{ mjekë} \times 2 \text{ muaj} = 51,584,000$  lekë.

Për mjekët që kanë filluar studimet në vitin akademik 2022-2023 dhe që përfundojnë ciklin e plotë të studimeve në vitin 2027, nëse nuk punësohen brenda periudhës 3-mujore, parashikohet që për këtë periudhë të përfitojnë 80% të pagës mesatare të mjekut të familjes 124,000 lekë, për muaj  $99.200/\text{muaj} \times 360 \text{ mjekë} \times 3 \text{ muaj} = 71,424,000$  lekë.

Për mjekët që kanë filluar studimet në vitin akademik 2023-2024 dhe që përfundojnë ciklin e plotë të studimeve në vitin 2028, nëse nuk punësohen brenda periudhës 3-mujore, parashikohet që për

këtë periudhë të përfitojnë 80% të pagës mesatare të mjekut të familjes 124,000 lekë, për muaj 99.200/muaj x 360 mjekë x 2 muaj = 79,360,000 lekë.

Kostot financiare që shoqërojnë ndryshimet e parashikuara në projektligj, do të konsiderohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për t'u përfshirë brenda tavaneve buxhetore gjatë procesit të përgatitjes së PBA 2025-2027, faza e dytë, për hartimin e projektbuxhetit të periudhës afatmesme 2025-2027.

## **VII. Diskutime në komision**

Kryetarja e Komisionit, znj. Zhupa, në mbledhjen e datës 17 shtator 2024, pasi bëri një përmbledhje të detajuar të të gjitha shqetësimeve dhe problematikave të projektligjit, duke u shprehur se është kundër miratimit të tij, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, ia dha fjalën deputetes nismëtare.

Znj. Gjonaj shpjegoi se projektligji “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të Arsimit të Lartë” ka ardhur si nevojë e zbatimit të vendimit nr. 1, datë 25.1.2024, të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka konsideruar se duhet të rishikohen afatet e përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr. 60/2023 deri në një kufi jo më të gjatë sesa tre vjet.

Kështu, rishikimi bëhet me qëllim që të garantohen parimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes dhe afatet e tjera tre dhe dyvjeçare të përcaktuara respektivisht në pikën 2, shkronjat “a” dhe “b”, dhe në pikën 3, shkronjat “a” dhe “b” të nenit 4, të ligjit nr. 60/2023.

Znj. Gjonaj shpjegoi se Gjykata Kushtetuese ka konsideruar se duhet të plotësohet vakuumi ligjor lidhur me punësimin e mjekëve dhe duhen garantuar të drejtat për trajtimin financiar në kuadër të sigurimit të mjeteve të nevojshme të jetesës, si dhe përlllogaritja e pagesës së periudhës në pritje në kohëzgjatjen e detyrimit të tyre për të punuar. Për zbatimin e këtij konstatimi janë propozuar ndryshime në nenin 6 të ligjit, ku është përcaktuar edhe punësimi i mjekëve, duke qartësuar procedurat dhe shtuar mundësitë për punësimin e tyre.

Në këtë aspekt është propozuar që për studentin, i cili përfundon programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të Arsimit të Lartë dhe ka nënshkruar marrëveshje sipas përcaktimeve të këtij ligji, në momentin e lindjes së të drejtës për punësimin e tij, fillimisht të ndiqen procedurat për t'u punësuar në institucionet shëndetësore, sipas nevojave për mjekë të shpallura nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe përzgjedhja e vendeve të punës të bëhet nga mjeku i licencuar, në bazë të renditjes sipas notës mesatare të përfundimit të studimeve.



Në mbledhjen e Komisionit të datës 10 shtator 2024, relatorja, znj. Zake, pas prezantimit të projektligjit, në fjalën e saj, theksoi se me hartimin e këtij projektligji, synohet të parandalohen emergjencat në sistemin tonë shëndetësor. Pasi shprehu mbështetjen e saj dhe vlerësoi nismën e ardhur në një moment të nevojshëm, i bëri thirrje anëtarëve të komisionit që ta miratojnë nismën e ardhur.

Në mbledhjen e datës 17 shtator 2024, relatorja e komisionit, zonja Bano, në fjalën e saj, theksoi se nuk ka asnjë ndryshim për detyrimin financiar të studentëve që nuk e nënshkruajnë kontratën dhe ende nuk ka një përlllogaritje deri më sot se sa është tarifa që ata duhet të paguajnë për ciklin 6-vjeçar, ndonëse e pazyrtaizuar ajo mbetet rreth 30 mijë euro.

Gjithashtu, znj. Bano, theksoi se krijohen dy standarte për trajtime të diferencuara për studentët që vazhdojnë studimet për mjekësi të përgjithshme. Një grup, në dukje të privilegjuar, pa dijeni, pasi me një nënshkrim kontrate kanë mundësinë të kenë shkollim pa paguar asnjë tarifë. Në rast se nuk i sigurohet punësimi brenda 3 muajve kanë të drejtën e një trajtimi financiar për një periudhë prej 9 muajsh të barabartë me vlerën e 80% të pagës bazë të mjekut të përgjithshëm, pra  $124,000 \times 80\% \times 9$  muaj (deri në 892,800 Lekë). Ose ata mund edhe të punësohen direkt në strukturat shëndetësore jopublike, pas ezaurimit të afatit 3 - muajor nga përfundimi i periudhës që Ministria duhet t'i hapë një vend pune.

Po ashtu, projektligji krijon konfuzion dhe nuk qartëson mënyrën se si studenti i diplomuar do mund të punësohet në strukturat publike, kur nuk mund të licencohet pranë Urdhërit, për shkak se diploma është transferuar pranë institucionit shëndetësor sipas marrëveshjes. Për më tepër, konfuzioni shtohet kur parashikohet se studenti i diplomuar mund dhe të punësohet direkt tek struktura jopublike dhe pas përfundimit të afatit 9 muajor për punësim prioritar, atij/asaj i hiqen të gjitha detyrimet për t'u punësuar deri në 3 vite dhe i jepet fizikisht diploma universitare. Për sa më lart, znj. Bano dhe një herë deklaroi se maxhoranca do të duhet të tërhiqet një herë e mirë nga kjo nismë apo dhe rishikim i saj, i cili shkon ndesh jo vetëm dispozitave të Kushtetutës, por krijon qartazi thellim të pabarazive në arsim si një e drejtë themelore dhe krijon shpenzime të tepërta shtesë për buxhetin e shtetit pa asnjë dobi. Në cilësinë e relatores, znj. Bano kërkoi tërheqjen e projektligjit dhe mosmiratimin e tij në Komision.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan këtë projektligj me argumentin se po shkelet kushtetuta e Republikës së Sshqipërisë dhe nuk po plotësohen kërkesat e studentëve, duke shkelur të drejtat bazë të njeriut.

***Përfundime:***

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, pasi vlerësoi:

**Në aspektin ligjor,** projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

**Në aspektin procedural,** projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

***Në përfundim,*** Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e komisionit përgjegjës, votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe e miratoi atë me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Deputetët e opozitës, të pranishëm në komision, votuan kundër kësaj nisme.

**RELATOR**

**Ensemvera Zake**

**Eralda Bano**

**KRYETAR**

**Ina Zhupa**